

VAN MECHELEN DHE TË TJERËT KUNDËR HOLLANDËS

Vendim i 23 Prillit 1997

PËRMBLEDHJE JO ZYRTARE DHE TË DHËNA MBI ÇËSHTJEN

A. *Faktet kryesore*

Kjo çështje ka si fillesë kërkesën ankimore të paraqitur përpara Komisionit nga katër shtetas Holandezë, Hendrik van Mechelen, Willem Venerius, Johan Venerius dhe Antonius Amandus Pruijboom, të cilët kishin lindur përkatësisht në 1960, 1961, 1962 dhe 1964.

Në Janar dhe Shkurt 1989, ankuesit, të cilët ishin vendosur nën mbikqyrje, në bazë të disa informacioneve të marra në lidhje me dyshimet për përfshirjen e tyre në disa vjedhje me armë në provincën e Norht Brabant, u arrestuan për veprën penale të vjedhjes me armë në një zyrë postare në Oirschot në 26 Janar, vjedhje e cila ishte shoqëruar me shkëmbime të vogla zjarri, duke lënë të plagosur një polic. Ata u akuzuan për vjedhje në rrethana rënduese dhe për shumë akuza të tjera për tentativë vrasjeje dhe vrasje pa paramendim. Ata nuk pranuan asnjërën prej akuzave dhe e bënë këtë gjë gjatë gjithë procesit penal që pasoi.

Në katër vendime të veçanta të shpallura më 12 Maj, 3 Gusht dhe 9 tetor 1989, Gjykata Rajonale e 's-Hertogenbosch i shpalli fajtorë ankuesit dhe e dënoi secilin prej tyre me 10 vjet heqje lirie (burgim). Ndër të tjera, vendimet bazoheshin në raportet e policisë që përmbanin deklarata të bëra nga oficerët e policisë që identifikoheshin vetëm nga një numër, pra që mbeteshin anonimë, si dhe thënie të dëshmitarëve, që ishin oficerë policie ose njerëz të zakonshëm që ishin ndodhur aty në momentin e vjedhjes.

Ankuesit e ankimuan vendimin përpara Gjykatës së Apelit të 's-Hertogensbosch, e cila ndryshe nga Gjykata Rajonale i trajtoi të katër çështjet në të njëjtën seancë. Mbrojtja kërkoi që oficerët e policisë që kishin mbetur anonimë, të pyeteshin në seancë të hapur gjyqësore. Megjithatë, Gjykata e Apelit, vendosi të pyeste të gjithë dëshmitarët me anë të një gjyqtari-hetues.

Gjyqtari-hetues pyeti gjithsej 23 dëshmitarë nën betim, njëmbëdhjetë nga të cilët nuk ju bënë të njohur mbrojtjes. Këta të fundit u pyetën nga gjyqtari-hetues në zyrën e tij (privatisht), ndërsa mbrojtja dhe akuza qëndruan në dhoma të ndryshme, të cilat ishin të lidhura me njëra-tjetrën dhe zyra e gjyqtarit-hetues shërbente si hallkë zanore.

Dëshmitarët e paidentifikuar ishin të gjithë oficerë policie. Secili prej tyre deklaroi se në qoftë se identiteti i tij do të zbulohet, ata nuk do të kishin më mundësi të kryenin siç duhet detyrat e tyre. Për më tepër, ata dëshironin të mbeteshin anonimë nga frika e ndëshkimeve kundër tyre ose familjeve të tyre. Ata të gjithë dhanë dëshmi prova që ripohonin deklaratat e paraqitura si provë përpara Gjykatës Rajonale të shkallës së parë.

Në raportin e tij zyrtar mbi dëshmitë e marra, gjyqtari-hetues deklaroi se ai ishte e njëjta identitetin e secilit prej dëshmitarëve anonimë dhe se ata ishin njëmbëdhjetë persona të ndryshëm. Në raport përmendeshin edhe arsyet e paraqitura prej tyre për të mbetur anonime, të cilat gjyqtari-hetues i vlerësoi si të besueshme dhe të mjaftueshme. Më tej në raport përmendeshin arsyet që kishte paraqitur gjyqtari-hetues që i vlerësonte thëniet e dëshmitarëve si të besueshme. Si akuza dhe mbrojtja kishin mundësi të bënin pyetje, dhe pyetja e secilit prej dëshmitarëve kishte zgjatur nga dy deri në pesë orë. Pyetjet që u bënë por nuk morën përgjigje – për arsye se ato mund të conin në zbulimin e identitetit të dëshmitarëve ose të metodave hetuese të përdorura nga policia – u regjistruan në proces-verbal. Të gjithë atyre që ishin të pranishëm gjatë procesit të pyetjeve, ju dha një kopje e projekt-raportit, dhe ata u lejuan të bënin komente mbi të.

Më pas, Gjykata e Apelit refuzoi kërkesat e paraqitura nga mbrojtja për ripyetjen e dëshmitarëve në seancë të hapur gjyqësore, por pyeti disa dëshmitarë, identiteti i të cilëve njëhej.

Në katër vendime të ndryshme të shpallura në 4 Shkurt 1991, Gjykata e Apelit i shpalli fajtorë të katër ankuesit për tentativë vrasjeje dhe vjedhje me dhunë dhe i dënoi ata me katërmëdhjetë vjet burgim. Pavarësisht nga thëniet e njëmbëdhjetë dëshmitarëve anonimë, provat e paraqitura përfshinin prova mjeko-ligjore dhe prova materiale, thënie të oficerëve të policisë të cilëve i njëhej identiteti dhe thënie të civilëve, dhe regjistrimet e një bisede telefonike ndërmjet gruas së ankuesit të tretë dhe nënës së saj. Identifikimi i ankuesve si autorë të veprës penale u bë vetëm nga oficerët anonimë të policisë.

Ankuesit bënë rekurs për shkelje të ligjit përpara Gjykatës Supreme. Rekursat e tyre u hodhën poshtë me katër vendime të ndryshme, në 9 Qershor 1992.

B. Proçesi përpara Komisionit European të të Drejtave të Njeriut

Kërkesat ankimore u paraqitën përpara Komisionit në 24 dhe 27 Nëntor dhe 8 Dhjetor të 1992; ato u pranuan në 15 Maj 1995.

Në raportin e tij të 27 Shkurtit 1996, Komisioni vlerësoi faktet dhe u shpreh se nuk bëhej fjalë për një shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës (njëzet vota pro dhe tetë kundër).

Komisioni European ja paraqiti çështjen për shqyrtim Gjykatës në 17 Prill 1996.

FRAGMENTE NGA VENDIMI

ANA LIGJORE

I. SHKELA E PRETENDUAR E NENIT 6 §§ 1 DHE 3 (D) TË KONVENTËS

46. Ankuesit pretendonin se dënimi i tyre bazohej kryesisht në thëniet e oficerëve të policisë, identiteti i të cilëve nuk njihej dhe që nuk ishin pyetur as publikisht dhe as në praninë e tyre. Ata pretendonin një shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3(d) të Konventës, sipas të cilëve:

“1. Gjithkush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht ... për pretendimet që mund të shfaqen ... nëse është e bazuar çdo akuzë penale e drejtuar kundër tij. Gjyqi duhet të bëhet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit ose publikut gjatë gjithë procesit ose gjatë një pjese të tij në interes të moralitetit, të rendit publik, ose të sigurimit kombëtar nënjë shoqëri demokratik, kur interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces e kërkojnë këtë gjë, ose për atë që sa e quan absolutisht të domosdoshme gjykata, kur rrethana të veçanta, publiciteti do të mund të dëmtonte interesat e drejtësisë.

...

3. Çdo person i akuzuar ka të drejtë ndër të tjera dhe kryesisht:

...

(d) të marrë në pyetje ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të kërkojë thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve që e shfajësojnë në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

...”

As Qeveria, as Komisioni nuk ishin dakord me këtë mendim.

A. Argumentat e paraqitura përpara Gjykatës.

47. Ankuesit vunë në dyshim nevojën për të ruajtur anonimatin e oficerëve të policisë. Sipas tyre as ata dhe as familjet e tyre nuk kërcënoheshin nga ndonjë rrezik. Kjo nga fakti që Z. Engelen, njëri prej dëshmitarëve që në fazat e para të procesit kishte bërë deklaratë që fajësonin njërin prej ankuesve, nuk kishte përfituar nga anonimati dhe nuk ekzistonte asnjë provë që ai të ishte kërcënuar ndonjëherë.

Për më tepër, pyetja e dëshmitarëve, sipas ankuesve, nuk duhej të bëhej përpara gjyqtarit-hetues. Sipas tyre, duhej që oficerët e policisë të pyeteshin në seancë të hapur gjyqësore, duke mbajtur maska, po të ishte e nevojshme.

Në vijim, ankuesit mendonin se atyre nuk ju ishin dhënë mundësi të mjaftueshme për të kundërshtuar dhe pyetur oficerët e policisë. Ata tërhoqën vëmendjen mbi kushtet në të cilat u zhvillua pyetja e dëshmitarëve.

Oficerët e policisë anonimë ishin mbyllur në një dhomë me gjyqtarin-hetues, pa praninë e ankuesve dhe të avokatëve të tyre; për ankuesit dhe avokatët e tyre nuk ishte e mundur të kuptohej nëse në dhomë ndodhej edhe ndonjë person tjetër dhe se çfarë po ndodhte realisht aty.

Jo të gjitha pyetjet e bëra nga mbrojtja kishin marrë përgjigje. Për shembull, pyetjet që nuk morën përgjigje përfshinin, pyetje të tilla si, ku ndodhej oficeri që po pyetej në momentin për të cilin po fliste, nëse ai e pa skenën e ngjarjes, dhe nëse vëzhgimi i furgonit përfshinte ndihmën me mjete optike apo të mikrofonave.

Së fundi, ankuesit pretendonin se vendimi për shpalljen e tyre fajtorë bazohej në një “masë të madhe” në provat e paraqitura nga dëshmitarët anonimë. Prova e vetme e paraqitur përpara Gjykatës së Apelit që identifikonte ankuesit si autorë të krimit ishte dhënë nga oficerët e policisë anonimë.

48. Qeveria dhe Komisioni gjykonin se nuk bëhej fjalë për një shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3(d).

Ato vlerësonin se sigura e oficerëve të policisë dhe familjeve të tyre, dhe nevoja për të mos dëmtuar punën e tyre në operacione të ngjashme, përbënin arsye të mjaftueshme për të justifikuar ruajtjen e anonimatit të tyre.

Procedura e ndjekur ishte vendosur nga Gjykata Supreme e Hollandës në vendimin e saj të 2 Korrikut 1990 (shiko paragrafin 40 më lart) në vazhden e vendimit të Gjykatës në çështjen Kostovski (vendim i 29 Nëntorit 1989, Seria A nr. 166). Kjo procedurë, argumentuan ata, ishte pranuar nga Gjykata në vendimin Doorson (Doorson kundër Hollandës, 26 Mars 1996, Raporte të Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-II).

Në përputhje me këtë procedurë, deklaratat e oficerëve të policisë ishin regjistruar (a) nga një gjyqtar, i cili (b) ishte siguruar personalisht për identitetin e policëve përkatës, (c) kishte dhënë mendim me shkrim për besueshmërinë dhe përgjegjësinë e tyre në raportin e tij zyrtar, (d) kishte paraqitur një opinion të arsyetuar për arsyet e policëve për të mbetur anonime dhe i kishte vlerësuar ato të mjaftueshme, dhe (e) i kishte dhënë mbrojtjes mundësi të mjaftueshme për t’i pyetur ata ose për t’u drejtuar pyetje atyre. Raporti zyrtar i gjyqtarit-hetues, i cili ishte shumë i hollësishëm, e provonte këtë gjë.

Gjithashtu, ishin paraqitur edhe prova të tjera nga burime jo-anonime, pra një bisedë telefonike e regjistruar, thënie të oficerëve të policies që u njihej identiteti dhe disa prova teknike që ripohonin thëniet e oficerëve të policisë. Pra, vendimi për shpalljen fajtorë të ankuesve nuk bazohej vetëm në thëniet e këtyre të fundit.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parimet e zbatueshme

49. Duke qënë se parashikimet e Nenit 6 §3 duhet të vlerësohen si aspekte të veçanta të të drejtës për një proces gjyqësor të drejtë të garantuar nga Neni 6 § 1, Gjykata do t'i shqyrtojë pretendimet e paraqitura në bazë të Nenit 6 §§ 1 dhe 3(d) të marra së bashku (shiko, ndërmjet vendimeve të tjera, vendimin e lartpërmendur Doorson, pp. 469-470, §66).

50. Gjykata thekson se pranimi i provave është kryesisht një problem që duhet rregulluar nga e drejta e brendshme dhe si rregull i përgjithshëm i përket gjykatave të brendshme të vlerësojnë provat e paraqitura përpara tyre. Në bazë të Konventës, detyra e Gjykatës nuk është të vendosë nëse thëniet e dëshmitarëve janë pranuar në mënyrën e duhur si prova, por të konstatojë nëse procesi në tërësi, përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, është i drejtë (shiko ndërmjet vendimeve të tjera, vendimin e lartpërmendur Doorson, p. 470, § 67).

51. Në vazhdim, të gjitha provat zakonisht duhet të administrohen në një seancë gjyqësore publike, në prani të të pandehurit, duke mbajtur parasysh argumentin e kundërshtimit të tyre. Sigurisht, ekzistojnë përjashtime nga ky parim, por këto përjashtime nuk duhet të çenojnë të drejtën e mbrojtjes; si rregull i përgjithshëm, paragrafet 1 dhe 3 (d) të Nenit 6 parashikojnë se të pandehurit t'i jepet mundësia e duhur për të kundërshtuar dhe pyetur çdo dëshmitar të paraqitur kundër tij, pavarësisht nga momenti kur ai jep dëshminë e tij apo në një fazë të mëvonshme (shiko vendimin Lüdi kundër Zvicrës, i 15 Qershorit 1992, Seria A nr. 238, p. 21, § 49).

52. Siç deklaroi Gjykata në çështjen Doorson (ibid., p. 470, § 69), përdorimi i thënieve të dëshmitarëve anonimë për të dhënë një vendim për shpallje fajtor nuk është tërësisht në përputhje me parashikimet e Konventës.

53. Në të njëjtin vendim Gjykata vuri në dukje sa më poshtë:

“Është e vërtetë se Neni 6 nuk parashikon shprehimisht marrjen parasysh të interesave të dëshmitarëve. Megjithatë, jeta, liria ose siguria e tyre mund të jënë elementë të tillë, saqë është e nevojshme që këto interesa të përfshihen në përgjithësi në sferën e Nenit 8 të Konventës. Këto interesa të dëshmitarëve dhe viktimave në parim mbrohen nga dispozita të tjera thelbësore të Konventës, të cilat nënkuptojnë se Shtetet Kontraktuese duhet ta organizojnë procesin e tyre penal në një mënyrë të tillë që interesat e këtyre personave të mos rrezikohen pa arsye. Kundrejt kësaj baze, parimi i procesit gjyqësor të drejtë kërkon që në rastet e duhura interesat e mbrojtjes të baraspeshohen me interesat e dëshmitarëve ose viktimave që janë thërritur të dëshmojnë.” (shiko vendimin e lartpërmendur Doorson, p. 470, §70).

54. Megjithatë, në qoftë se anonimati i dëshmitarëve të akuzës do të ruhet, mbrojtja do të përballet me veshitësi që normalisht nuk ekzistojnë gjatë procesit penal. Gjithashtu,

Gjykata e pranon faktin që në raste të tilla, Neni 6 § 1 së bashku me Nenin 6 § 3 (d) të Konventës parashikojnë se mangësitë nën të cilat vepron mbrojtja duhet të baraspeshohen në një masë të mjaftueshme nga procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore (ibid., p. 471, § 72).

55. Së fundi, duhet të theksohet se vendimi për shpallje fajtor nuk duhet të bazohet vetëm ose në një masë të madhe në thënie anonime (ibid., p. 472, § 76).

2. Zbatimi i parimeve të mësipërme

56. Sipas mendimit të Gjykatës, baraspeshimi i interesave të mbrojtjes me argumentat në favor të ruajtjes së anonimatit të dëshmitarëve ngre probleme specifike për faktin nëse dëshmitarët janë pjesëtarë të forcave policore të Shtetit. Megjithëse interesat e tyre – dhe ato të familjeve të tyre – meritojnë mbrojtjen e Konventës, duhet të pranohet fakti që pozicioni i tyre deri në një farë mase është i ndryshëm nga ai i një dëshmitari apo viktime të painteresuar. Ata janë të detyruar t'i binden autoriteteve ekzekutive të shtetit dhe zakonisht kanë lidhje me akuzën; për këto motive, përdorimi i tyre si dëshmitarë anonimë duhet të bëhet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Në vijim, është në natyrën e punës së tyre, që detyrat e tyre, veçanërisht në rastin e oficerëve që kryejnë arrestimet, të përfshijnë edhe dhënien e dëshmive në proces të hapur gjyqësor.

57. Nga ana tjetër, Gjykata në parim e ka pranuar se është e justifikueshme për autoritetet policore të dëshirojnë të ruajnë anonimin e agjentëve të përfshirë në veprimtari të fshehta, për mbrojtjen e tyre ose të familjeve të tyre dhe të mos dëmtojnë në këtë mënyrë punën e tyre për operacionet në të ardhmen, por me kusht që të drejtat e mbrojtjes të mbrohen (shiko vendimin e lartpërmendur Lüdi, p. 21 § 49).

58. Duke patur parasysh vendin që zë e drejta për një administrim të drejtë të drejtësisë në një shoqëri demokratike, çdo masë që kufizon të drejtën e mbrojtjes duhet të jetë e domosdoshme. Nëse mund të përdoret një masë më pak kufizuese, atëherë do të jetë ajo masë që do të përdoret.

59. Në rastin në fjalë, oficerët e policisë ndodheshin në një dhomë të veçantë me gjyqtarin hetues, dhomë në të cilën nuk ndodheshin as të pandehurit dhe as avokatët e tyre. Të gjitha komunikimet bëheshin nëpërmjet një lidhjeje zanore. Pra, mbrojtja jo vetëm nuk e njihte identitetin e policëve dëshmitarë, por edhe nuk mund të vëzhgonte sjelljen e tyre gjatë procesit të drejtpërdrejtë të pyetjeve, pra në këtë mënyrë nuk mund të vlerësonte besueshmërinë e tyre (shiko vendimin e lartpërmendur Kostovski, p. 20, § në fund).

60. Përpara Gjykatës nuk u shpjegua arsyeja përse ishte e nevojshme vendosja e një kufizimi të tillë ekstrem të të drejtës së të pandehurit për dhënien e dëshmive kundër tyre në prani të tyre, ose përse nuk u morën parasysh masa më pak ekstreme.

Në mungesë të të dhënave të tjera, Gjykata nuk mund ta vlerësojë nevojën funksionale të policisë si justifikim të mjaftueshëm. Duhet theksuar se Memorandumi

Shpjegues i Projekt-Ligjit që u miratua si Ligj në 11 Nëntor 1993 (shiko paragrafin 42 më lart), në lidhje me këto fakte përmend mundësinë e përdorimit të maskave ose trukeve dhe ndalimin e kontaktit të drejtpërdrejt me shikimin e të pranishëmve.

60. Madje Gjykata nuk është e bindur që edhe Gjykata e Apelit ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të vlerësuar mundësinë e kanosjeve apo ndëshkimeve kundër oficerëve të policisë dhe familjeve të tyre. Nga vendimi i gjykatës nuk del në pah ndonjë e dhënë që ajo u përpoq të trajtonte problemin nëse ankuesit do të kishin mundësi të kryenin kanosje të tilla apo të nxisnin dikë tjetër t'i kryente ato në emër të tyre. Vendimi i kësaj gjykate bazohej tërësisht në seriozitetin e krimeve të kryera. (shiko paragrafin 26 më lart).

Në lidhje me këtë, duhet theksuar se Z. Engelen, një dëshmitar civil i cili në fazat e para të procesit kishte bërë deklaratat që identifikonin njërin prej ankuesve si njërin prej autorëve të krimit, nuk përfitoi mbrojtjen e anonimitetit dhe ai nuk u ankua asnjëherë se ishte kërcënuar.

62. Është e vërtetë - siç është theksuar nga Qeveria dhe Komisioni (shiko paragrafin 48 më lart) – se oficerët anonimë të policisë u pyetën përpara një gjyqtari-hetues, i cili e kishte verifikuar personalisht identitetin e tyre, dhe në një raport tepër të hollësishëm zyrtar mbi vlerësimet e tij, kishte shprehur mendimin e tij mbi besueshmërinë dhe përgjegjësinë e tyre si dhe për motivet e paraqitura prej tyre që të mbeteshin anonimë.

Megjithatë, këto masa nuk mund të vlerësohen si zëvendësuesi i duhur i mundësisë së mbrojtjes për të pyetur dëshmitarët në praninë e saj dhe për të krijuar mendimin e tyre personal mbi besueshmërinë dhe sjelljen e tyre. Pra nuk mund të thuhet se mangësitë me të cilat u përball mbrojtja gjatë punës së saj, u baraspeshuan nga procedurat e mësipërme.

63. Për më tepër, prova e vetme ku u bazua Gjykata e Paelit, e cila identifikonte ankuesit si autorë të krimeve, ishin thëniet e oficerëve të policisë anonimë. Pra në këtë mënyrë, vendimi për shpalljen fajtorë të ankuesve bazohej “në një masë përcaktuese” në këto thënie anonime.

64. Sipas Gjykatës, duhet të bëhet një dallim i çështjes së mësipërme nga ajo Doorson: në çështjen Doorson vendimi u bazua në të dhënat që u morën nga dosja e çështjes dhe jo nga dëshmitarët.

Y. 15 dhe Y. 16 – të cilët ishin të dy civilë, dhe që e njihnin të pandehurin personalisht – kishin arsye të mjaftueshme për të besuar se ndaj tyre mund të ushtrohej dhunë, dhe kështu që ata u pyetën në prani të avokatit (shiko vendimin e lartpërmendur Doorson, p. 454-55, § 25, pp. 455-56, § 28, dhe pp. 470-71, §§ 71 dhe 73).

Në vijim, në çështjen e fundit provat e tjera që identifikonin të pandehurin si autor të krimeve u morën nga burime të tjera që nuk kishin lidhje me dëshmitarët anonimë (ibid., pp. 458-59, § 34 dhe p. 472, § 76).

65. Në bazë të këtyre fakteve, Gjykata nuk mund ta vlerësojë procesin në tërësinë e tij si të drejtë.

C. Përfundim

66. Bëhet fjalë për një shkelje të Nenit 6 § 1 të marrë së bashku me Nenin 6 § 3(d).

II. ZBATIMI I NENIT 50 TË KONVENTËS

67. Neni 50 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Në qoftë se vendimi i Gjykatës deklaron se një vendim i marrë ose një masë e urdhëruar nga një autoritet gjyqësor ose çdo autoritet tjetër të një Pale të Lartë Kontraktuese është tërësisht ose pjesërisht në kundërshtim me detyrimet që rrjedhin nga kjo Konventë, dhe në qoftë se e drejta e brendshme e Palës në fjalë lëjon të zhduken pasojat e atij vendimi ose të asaj mase jo krejtësisht, vendimi i Gjykatës i jep, kur është rasti, një shpërblim të arsyeshëm palës së dëmtuar”.

A. Dëmi

68. Ankuesit pretendonin se nëse Gjykata e Apelit e ‘s-Hertogenbosch nuk do të ishte bazuar në thëniet e oficerëve anonimë të policisë, atëherë nuk do të kishte filluar asnjë çështje kundër tyre dhe për rrjedhojë ata do të ishin shpallur të pafajshëm. Secili prej tyre pretendoi një dëm jo-financiar në një shumë prej 250 gulden Hollandezë (NLG) për çdo ditë burgim.

Qeveria e vlerësoi pretendimin e ankuesve për dëmet e shkaktuara “të lartë dhe jo në përpjestim”.

Përfaqësuesi i Komisionit nuk bëri asnjë koment.

69. Gjykata vlerëson se në rrethanat e çështjes, ky aspekt i çështjes nuk është gati për vendim. Gjithashtu, është e nevojshme që ajo të rezervohet, duke marrë parasysh mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet Shtetit të paditur dhe ankuesve.

B. Shpenzimet dhe kostot.

70. Ankuesit nuk paraqitën asnjë pretendim për shpenzimet e tyre gjatë zhvillimit të procesit penal në nivel të brendshëm.

Në lidhje me shpenzimet për procesin përpara Komisionit European dhe Gjykatës European të të Drejtave të Njeriut, ankuesit pretenduan sa më poshtë vijon:

Z. van Mechelen dhe Z. Willem Venerius (përfaqësuar nga Z. Spronken): 16,598.07 NLG, përfshirë edhe tatimin mbi vlerën e shtuar;

Z. Johan Venerius (përfaqësuar nga Z. Sjöcrona): 30,446.43 NLG, përfshirë edhe tatimin mbi vlerën e shtuar;

Z. Pruijboom (përfaqësuar nga Z. Knoops): 11,905 NLG, përfshirë edhe tatimin mbi vlerën e shtuar;

Qeveria dhe Përfaqësuesi i Komisionit nuk bënë asnjë koment mbi këto pretendime.

71. Gjykata thekson se Z. van Mechelen, Z. Johan Venerius dhe Z. Willem Venerius kanë përfituar ndihmë ligjore falas nga institucionet e Konventës.

72. Gjykata është e bindur se ankuesit i kanë kryer shpenzimet e pretenduara, në përpjekjet e tyre për të ndrequr shkeljet e gjykuara. Gjithashtu, ajo mendon se shumatat e pretenduara nga ankuesit Van Mechelen, Willem Venerius dhe Pruijboom janë të arsyeshme përse i përket sasisë.

Nga ana tjetër, pretendimi i Z. Johan Venerius nuk është në përpjestim po të krahasohet me pretendimet e ankuesve të tjerë. Për këtë diferencë të madhe nuk jepet asnjë shpjegim.

73. Gjykata i jep Z. Pruijboom shumën e kërkuar.

Z. Van Mechelen dhe Z. Willem Venerius, bashkarisht, i jep shumën e pretenduar, duke zbritur shumën e paguar atyre nga Këshilli i Europës për ndihmën ligjore falas, pra 11,412 franga Franceze (FRF).

Duke vendosur në bazë asnjënjësie, Gjykata i jep Z. Johan Venerius 20,000 NLG, plus tatimin mbi vlerën e shtuar, duke zbritur shumën e paguar nga Këshilli i Europës për ndihmën ligjore falas, pra FRF 11,436.

C. Interesat e papaguara

74. Sipas informacionit në dispozicion të Gjykatës, norma ligjore e interesit që zbatohet në Hollandë në datën e marrjes së këtij vendimi është 5% në vit.

PËR KETO ARSYE, GJYKATA

1. *Vendosi* me gjashtë vota pro dhe tre kundër se ka ndodhur një shkelje e Nenit 6 § 1 të Konventës, të marrë së bashku me Nenin 6 § 3(d);

2. *Vendosi* njëzëri se shteti i paditur duhet të paguajë, brenda tre muajve, të gjitha shpenzimet,
- (a) ankuesve Van Mechelen dhe Willlem Venerius së bashku, 16, 598.07 (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëqind gulden e shtatë cent) NLG, duke zbritur 11,412 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e dymbëdhjetë Franga Franceze) FRF, që do të kthehen në gulden me kursin e këmbimit në datën e shpalljes së këtij vendimi;
 - (b) ankuesit Johan Venerius, 20,000 (njëzet mijë gulden holandezë) NLG, duke zbritur 11, 436 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë franga Franceze) FRF, që do të kthehen në gulden me kursin e këmbimit në datën e shpalljes së vendimit;
 - (c) ankuesit Pruijmbloom, 11,905 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesë gulden Holandezë);
 - (d) që interesi vjetor prej 5% do të paguhet që nga data e skadimit të afatit të lartpërmendur prej tre muajsh deri në zgjidhjen e çështjes;
3. *Rrëzon* njëzëri pjesën tjetër të pretendimit të ankuesit Johan Venerius për rimbursimin e shpenzimeve;
4. *Vendos* njëzëri se çështja e zbatimit të Nenit 50 të Konventes në lidhje me pretendimet e ankuesve për dëmet e shkaktuara nuk është gati për marrjen e një vendimi dhe për rrjedhojë,
- (a) e rezervon këtë çështje;
 - (b) e fton Qeverinë dhe ankuesit të paraqesin, brenda tre muajve pasardhës, vërejtjet e tyre me shkrim për çështjen dhe, në veçanti, të njoftojnë Gjykatën për çdo marrëveshje të arritur ndërmjet tyre;
 - (c) rezervon procedurën e mëtejshme dhe i delegon Kryetarit të Dhomës, kompetencat për të përcaktuar procedurën, në qoftë se është e nevojshme;

Hartuar në Anglisht dhe Frengjisht, dhe shpallur publikisht në seancë të hapur gjyqësore, në Selinë e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, në 23 Prill 1997.

Rudolf BERNHARDT
Kryetar

Herbert PETZOLD

Sekretar

Në përputhje me Nenin 51 § 2 të Konventës dhe Rregullit 55 § 2 të Rregullores B të Gjykatës, mendimet e mëposhtme do t'i bashkangjiten këtij vendimi:

- (a) mendimi i pakicës i Z. Matscher dhe Z. Valticos;
- (b) mendimi i pakicës i Z. van Dijk;

H.P.

R.B.

MENDIMI I PAKICËS I GJYQTARËVE MATSCHER DHE VALTICOS

Kjo është një çështje tepër delikate. Nga njëra anë, kushtet në të cilat u zhvillua procesi dhe në të cilat u pyetën dëshmitarët, nuk ishin plotësisht të kënaqshme dhe pa dyshim që ato mund të përmirësoheshin, megjithëse duhet pranuar se në legjislacionin Hollandez janë bërë përpjekje për të përshtatur procedurën e pyëtjes së dëshmitarëve anonimë me parashikimet e Nenit 6 të Konventës, siç përmendet edhe në vendimin Kostovski kundër Hollandës (20 Nëntor 1989, Seri A nr. 166). Nga ana tjetër, kjo ishte një çështje për vjedhje me armë dhe është e kuptueshme që dëshmitarët – edhe kur ata janë oficerë policie – të kenë frikë nga ndëshkimet e kriminelëve gjaknxehtë. Nëse çështje të ngjashme do të paraqiten në të ardhmen, do të ishte pa dyshim e pëlqyeshme që, gjatë marrjes së masave, të tregohej një vëmendje më e madhe ndaj parashikimeve të Nenit 6 të Konventës.

Megjithatë, në këtë rast, duke patur parasysh edhe të gjitha rrethanat e çështjes, ne nuk vlerësojmë se jemi përballë një shkeljeje të Nenit 6 të Konventës dhe jemi plotësisht dakord me mendimin e Gjyqtarit van Dijk.

MENDIMI I PAKICËS I GJYQTARIT VAN DIJK

1. Me keqardhe ju vë në dijeni se unë nuk jam dakord me përfundimin e arritur nga shumica, që në çështjen në fjalë ka ndodhur një shkelje e Nenit 6 paragrafi 1 së bashku me paragrafin 3(d) të Konventës. Gjithashtu, nuk jam dakord me shumicën as për sa i përket thelbit të arsyetimit që e mbështet këtë përfundim.

2. Megjithëse rastet gjyqësore të Gjykatës nuk janë zhvilluar plotësisht në lidhje me kushtet në të cilat një vendim për shpallje fajtor në një proces penal mund të bazohet pjesërisht në thëniet e dëshmitarëve anonimë, Gjykata ka përcaktuar disa linja veprimi. Jam i mendimit se ky vendim nuk është as në përputhje me këto linja dhe as një vazhdim logjik i tyre, ndërsa nga ana tjetër, faktet e çështjes nuk janë të përcaktuara në një masë të tillë sa të justifikojnë dallimin e kësaj çështjeje nga ajo Doorson (Doorson kundër

Hollandës, vendim i 26 Marsit 1996, Raportet 1996-II, në të cilën u gjykua se Holanda nuk e kishte shkelur Nenin 6 § 1 të marrë së bashku me Nenin 6 § 3(d)). Megjithëse, Gjykata nuk është e detyruar nga precedentët, siguria dhe barazia ligjore kërkojnë që rastet gjyqësore të Gjykatës të jenë të plota dhe transparente si dhe arsyeshmërisht të parashikueshme, për aq sa faktet e çështjes mund të krahasohen me ato të një çështjeje më të hershme.

3. Duke qënë se “pranimi i provës është kryesisht një çështje që rregullohet nga e drejta e brendshme dhe si rregull i përgjithshëm i përket gjykatave të brendshme të gjykojnë provat e paraqitura përpara tyre” (shiko vendimin Doorson, p. 470, § 67), legjislacioni dhe rastet gjyqësore të brendshme që do të zbatohen, si dhe praktika e ndjekur nga gjykatat e brendshme janë deri në njëfarë mase përcaktuese edhe për Gjykatën.

Gjykata Supreme e Hollandës i rishikoi rastet e saj gjyqësore në lidhje me kushtet në të cilat një vendim për shpallje fajtor mund të bazohej në dëshmitarët anonimë, në lidhje me një vendim të gjykatës në çështjen Kostovski (shiko paragrafin 40 të këtij vendimi). Për më tepër, duke marrë si pikënisje dhe duke u bazuar në rastet gjyqësore të rishikuara, ndër të tjera, nga një analizë e rasteve gjyqësore të Gjykatës mbi pranimin e thënieve të dëshmitarëve anonimë në proceset penale dhe futjen e rasteve gjyqësore të Gjykatës në të drejtën dhe praktikën ligjore përkatëse të brendshme në Hollandë, Qeveria e Hollandës propozoi dhe ligjvënësi miratoi, shumë ndryshime të Kodit të Procedurës Penale (shiko paragrafin 41 të vendimit dhe Memorandumin Shpjegues të Ligjit të 1993, cituar më lart).

Ligji i 1993 nuk kishte hyrë ende në fuqi në momentin kur u dhanë vendimet e gjykatave të brendshme mbi çështjen në fjalë. Megjithatë, në qoftë se ai do të kishte hyrë në fuqi, procedura e ndjekur nga Gjykata e Apelit do të ishte në përputhje me rregullat e reja të parashikuara. Është e vërtetë se arsyet e radhitura në Ligj për mbajtjen të fshehtë të identitetit të dëshmitarit nuk përfshinin, qëllimin e mosbërjes të ditur të identitetit të një oficeri policie për të mos dëmtuar punën e tij në të ardhmen. Memorandumi Shpjegues (Komentari) i Ligjit parashikon me shumë fjalë se sipas mendimit të Qeverisë, interesi publik gjatë hetimit të krimeve të rënda nuk mund të justifikohet vetëm me garantimin e anonimitetit të plotë (shiko paragrafet 41 dhe 42 të këtij vendimi).

Megjithatë, Gjykata e Apelit nuk e bazoi pranimin e saj në dëshirën e dëshmitarëve për të mbetur anonimë për këtë arsye, por në frikën e tyre për jetën dhe sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre (shiko paragrafin 26 të vendimit në fjalë), gjë që është një motiv i pranueshëm në bazë të Nenit 226 a të Kodit të Procedurës Penale.

Përfundimet e mësipërme, sigurisht, nuk garantojnë në vetvete se rastet gjyqësore të rishikuara të Gjykatës Supreme dhe/ose dispozitat përkatëse të ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale do të jenë në të gjitha rrethanat në përputhje me Konventën. Megjithatë, sic është theksuar edhe më lart, në këtë çështje, rastet gjyqësore dhe legjislacioni i brendshëm kanë rëndësinë e tyre. Për më tepër, në rastin në fjalë, sipas kuadrit ligjor të rasteve gjyqësore përkatëse në Hollandë dhe historisë së hartimit të ligjeve të reja, në të cilat janë marrë parasysh shprehimisht edhe rastet gjyqësore të

Strasburgut, duket sikur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të hedhur një hipotezë mbi përputhjen e tyre me Konventën, të paktën, për aq sa ato çështje që trajtohen janë shqyrtuar edhe në rastet gjyqësore të Strasburgut.

4. Vlerësimi i çështjeve të ndryshme të trajtuara së fundi, më kanë cuar në përfundimin se Neni 6 §§ 1 dhe 3(d) nuk janë shkelur në çështjen në fjalë. Sigurisht do të ishte e pëlqyeshme që Gjykata e Apelit apo gjyqtari-hetues t'i kishin pyetur dëshmitarët në prani të avokatit apo të Prokurorit të Përgjithshëm, duke i dhënë mundësi të pandehurit ta ndiqte këtë proces në një dhomë të veçantë. Nga dosja e çështjes unë nuk mund ta kuptoj nëse një mundësi e tillë u mor parasysh nga Gjykata. Duke supozuar se po, dhe duke patur parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, mendoj se e drejta e mbrojtjes për të pyetur dëshmitarët nuk kufizohej deri në atë masë sa mbrojtjes të mos i jepej një mundësi e përshtatshme për të kundërshtuar dhe pyetur dëshmitarët, sic parashikohet nga Neni 6 §§ 1 dhe 3(d) (shiko Lüdi kundër Zvicrës, vendim i 15 Qershorit 1992, Seria A nr. 238, p. 21, § 47). Për këtë arsye mendoj se procesi gjyqësor ishte i drejtë, duke marrë parasysh edhe elementët kompensues të procedurës të vendosura nga Gjykata e Apelit dhe të ndjekura nga gjyqtari-hetues. Duke arritur në këtë përfundim, unë do të vija në dukje aspektet e mëposhtme:

- (a) Dëshmitarët anonimë nuk u pyetën vetëm nga organi akuzues, por edhe nga një gjyqtar i pavarur dhe i paanshëm, që duke gjykuar nga raporti i tij zyrtar për vlerësimet e tij, të paraqitur përpara Gjykatës së Apelit, u tregua shumë i kujdesshëm për të kompensuar mbrojtjen për shkak të mangësisë që vinte si rezultat i mos ballafaqimit të palëve. Ankuesit dhe avokati i tyre mund të dëgjonin pyetjet e drejtuara nga gjyqtari-hetues dhe të bënin edhe vetë pyetje. Në këtë drejtim, sic u vu në dukje edhe nga Komisioni, çështja në fjalë ndryshon nga çështjet Kostovski (Kostovski kundër Hollandës, vendim i 20 Nëntorit 1989, Seria A nr. 166, p. 20, § 42), Windisch (Windisch kundër Austrisë, vendim i 27 Shtatorit 1990, Seria A nr. 186, p. 10, § 27), Lüdi (loc. Cit., p. 21, § 49), dhe Saïdi (Saïdi kundër Francës, vendim i 20 Shtatorit 1993, Seria A nr. 261-C, pp. 56-57, § 44). Gjykata në çështjen Doorson, e pranoi një praktikë e tillë, si në çështjen në fjalë, pra ku dëshmitarët pyeten nga gjyqtari-hetues dhe jo nga vetë trupi gjykues në një proces gjyqësor, si në përputhje me Konventën (loc. Cit., p. 471, të tilla 73).
- (b) Gjykata e Apelit paraqiti motive për t'ja deleguar gjyqtarit-hetues të drejtën e pyetjes së dëshmitarëve. Pësia që pakica e Komisionit i dha faktit që Gjykata e Apelit, duke qënë gjykatë sipas kuptimit të ligjit, nuk e përdori mundësinë për ta verifikuar vetë besueshmërinë e dëshmitarëve, sipas mendimit tim, nuk është përcaktuese; nuk ka asnjë motiv përse gjykata nuk mund të bazohej për këtë, në gjykimin e një gjyqtari-hetues njëlloj të pavarur dhe të paanshëm. Në lidhje me këtë, ka gjithashtu rëndësi që procesi i pyetjeve përpara gjyqtarit-hetues nuk u zhvillua në një fazë para gjyqësore por gjatë një pezullimi të procesit gjyqësor përpara Gjykatës së Apelit dhe në zbatim të një urdhri të Gjykatës së Apelit; ai

ishite pjesë e procesit. Në çështjen Kostovski, në të cilën Gjykata theksoi rëndësinë e mundësisë që ka gjyqtari i procesit për të vëzhguar dëshmitarët, vetëm njëri nga dëshmitarët u pyet nga gjyqtari, dëshmitar i cili megjithatë, nuk kishte dijeni për identitetin e personit në fjalë. (loc. Cit., p. 21, të tilla 43).

- (c) Deklaratat e bëra përpara gjyqtarit-hetues ishin deklarata të dëshmitarëve të cilët ishin identifikuar nga gjyqtari –hetues në momentin e duhur, si oficerë policie që kishin kryer betimin dhe që ishin të autorizuar për të kryer detyrën e ndjekjes së veprave penale dhe të veshur me kompetenca hetimore, dhe ishin nën betim për çdo deklaratë të bërë në lidhje me këtë (shiko vendimin Ludi, p. 21, § 49).
- (d) Gjyqtari-hetues, e cili i kishte vëzhguar dëshmitarët gjatë procesit të pyetjeve, dha një opinion të arsyetuar mbi besueshmërinë e tyre; kjo kishte si qëllim edhe të kompensonte mbrojtjen për pamundësinë e saj për informacionin pamor, që do t'i lejonte atë të kontrollonte besueshmërinë e dëshmitarëve (shiko vendimin Windisch, pp. 10-11, §§ 28-29).
- (e) Gjyqtari-hetues dha një mendim të arsyetuar nëse dëshira e oficerëve të policisë për të mbetur anonimë ishte e bazuar; këto arsye u vlerësuan si të bazuara nga Gjykata e Apelit, në bazë të fakteve të paraqitura në vendimin e saj. Mendimi i tyre i përbashkët ishte se akuzat dhe ngjarjet ishin të tilla, saqë frika për ndëshkime të dhunshme që nuk ishte krejtësisht e pabazuar, nuk mund të gjykohej e pamotivuar. Neni 6 nuk garanton një të drejtë të pakufizuar për të pyetur dëshmitarët. Është e nevojshme jo vetëm të njihen kompetencat e gjykatave të brendshme për të ruajtur përputhjen me kushtet e administrimit të duhur të drejtësisë, por edhe të baraspeshohen interesat e mbrojtjes në bazë të Nenit 6 me ato të dëshmitarëve të mbrojtur nga dispozita të tjera thelbësore të Konventës (shiko vendimin Doorson, p. 470, § 70). Megjithatë në vendimin Ludi (loc.cit., p. 21, § 49) Gjykata e vlerësoi interesin e autoriteteve të policisë për të ruajtur anonimin e agjentëve të saj, si të “ligjshëm”, në këtë çështje duhej t’i jepet peshë më e madhe, sic u bë nga Gjykata e Apelit, interesave të agjentëve për mbrojtjen e jetës së tyre dhe sigurisë së familjeve të tyre (Nenet 2, 3, 5 dhe 8 të Konventës).
- (f) Mbrojtjes ju dhanë mundësi të gjëra për të dëgjuar dhe pyetur dëshmitarët, dhe për të bërë komente mbi regjistrimin e përgjigjes së tyre, dhe në fakt ajo e përdori gjerësisht këtë mundësi; mangësitë teknike të pretenduara ishin të papërshtatshme dhe mund të shmangeshin, por duke patur parasysh kohën e gjatë të zhvillimit të procesit dhe mënyrën e hollësishme të regjistrimit të thënieve, këto mangësi nuk ishin të tilla sa ta pengonin mbrojtjen në një mënyrë përcaktuese.

- (g) Gjykata e Apelit nuk e përjashtoi menjëherë mundësinë e bërjes së pyetjeve shtesë dëshmitarëve në proces gjyqësor, por mendonte se mbrojtja nuk e kishte mbështetur në mënyrë të mjaftueshme dëshirën e saj për ta bërë një gjë të tillë. Për më tepër, mbrojtjes iu ofrua mundësia për t'i kundërshtuar thëniet dhe përdorimin e tyre si provë në seancë të hapur gjyqësore përpara Gjykatës së Apelit.
- (h) Vendimet për shpalljen fajtor nuk bazoheshin vetëm në thëniet e dëshmitarëve anonimë. Megjithatë ato përbënin pa dyshim thelbin e provave, ekzistonin edhe thënie të tjera të dëshmitarëve të identifikuar, ekzistoni disa prova teknike, si dhe disa regjistrime të bisedave telefonike. Gjithashtu, në lidhje me këtë, Gjykata duhet ta pranojë se “si rregull i përgjithshëm i përket gjykatave të brendshme të gjykojnë provat e paraqitura përpara tyre”.

Në vendimin Doorson, në të cilin u zhvillua dhe u zbatua kriteri i “masës përcaktuese” (loc. Cit., p. 472, § 76), Gjykata vlerësoi se ky kriter ishte përmbushur në atë rast kur vendimi për shpallje fajtor ishte bazuar, përveç thënieve të dëshmitarëve anonimë, në një dëshmi të dhënë nga një dëshmitar i identifikuar përpara policisë, por të tërhequr gjatë procesit gjyqësor dhe nga një dëshmi e një dëshmitari që ishte zhdukur përpara se mbrojtja ta pyeste atë (loc.cit., p. 472, § 76, në lidhje me pp. 458-59, § 34).

Në lidhje me të gjitha këto aspekte të çështjes, unë arrita në përfundimin se procesi gjyqësor që çoi në shpalljen fajtorë të ankuesve ishte “i drejtë” sipas kuptimit të Nenit 6 të Konventës siç është interpretuar ai në rastet gjyqësore të mëparshme të Gjykatës.

Duke dhënë përfundimin tim, dëshiroj, me respektin e duhur, të jap vërejtjet e mëposhtme në lidhje me arsyetimin në të cilin shumica bazon përfundimet e saj.

5. Ashtu si edhe shumica, dhe në përputhje me rastet gjyqësore të Gjykatës, do të marr si pikënisje atë provë që normalisht duhet të paraqitet në një proces gjyqësor publik. Për këtë arsye, unë e vlerësoj si absurditet që pyetja e oficerëve të policisë në proces gjyqësor përpara Gjykatës së Apelit, të maskuar po të ishte e nevojshme për të ruajtur anonimatin, do të ishte e preferueshme. Megjithatë, gjithashtu marr parasysh mendimin e Gjykatës së Apelit që kjo do të ishte shumë e rrezikshme, për arsye se nuk përjashtohet zbulimi i identitetit të dëshmitarëve. Do të preferoja të bëhej kjo gjë, nëse Gjykata e Apelit do të paraqiste argumenta konkrete për këtë mendim, por nga ana tjetër, unë nuk jam ekspert – ashtu si, supozoj, kolegët e mi të Gjykatës - për të gjykuar nëse frika e saj ishte e justifikuar apo jo. Gjithshtu, dikush mund të çuditet nëse mbrojtja do të ishte në një pozitë më të mirë po të vëzhgonte sjelljen e dëshmitarëve dhe të kontrollonte besueshmërinë e tyre, nëse ata do të paraqiteshin të maskuar, duke patur parasysh se një maskim mund të fshihte në thelb edhe tingujt dhe tonin e zërit, si dhe gjestet e personit në fjalë. Në përgjithësi, gjykata e brendshme mund të vlerësohet në një pozitë më të favorshme për të gjykuar një çështje të tillë të ndërlikuar faktike, se Gjykata jonë, e cila duhet ta zëvendësojë vendimin e gjykatës së brendshme me të sajën, vetëm në qoftë se

vendimi i gjykatës së brendshme është i paarsyeshëm. Nga formulimi i vendimit Doorson, është e qartë se në atë çështje Gjykata e pranoi këtë përgjegjësi thelbësore të gjykatës së brendshme.

6. Fakti që oficerët e policisë, u ndodhë nën zjarrin e ankuesve gjatë ndjekjes, nuk do të thotë se në një fazë të mëvonshme, gjatë ose pas procesit, jeta e tyre dhe siguria e tyre dhe/ose e familjeve të tyre nuk ishte në rrezik. Megjithatë, nga të dyja këto këndvështrime, autoriteteve kombëtare – në rastin në fjalë gjykatave kombëtare – duhet t’ju lihet një farë lirie veprimi për të baraspeshuar interesat e mbrojtjes me ato të dëshmitarëve (shiko vendimin Doorson, p. 470, § 70, kur u vu në zbatim një test i arsyeshmërisë). Sipas mendimit tim, Gjykata e Apelit nuk e ka kapërcyer kufirin duke vlerësuar se rreziku i zbulimit të identitetit të dëshmitarëve ishte i pranishëm dhe frika e tyre për jetën e tyre dhe sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre ishte e justifikueshme, duke patur parasysh seriozitetin e krimeve të kryera dhe dhunën e përdorur.

Unë nuk jam dakord me shumicën, se Gjykata e Apelit nuk bëri asnjë përpjekje reale për të vlerësuar kërcënimet për ndëshkime. Gjykata e Apelit kishte në dispozicion të saj raportin e vlerësimeve të gjyqtarit-hetues, në të cilin ky i fundit kishte pasqyruar jo vetëm thëniet e dhëna nga oficerët e policisë – të cilat në disa raste mbështeteshin edhe në përvojën e mëparshme (paragrfet 17 dhe 21 të vendimit) – por edhe vlerësimin e tij, të bazuar në seriozitetin e krimeve dhe dhunën e përdorur nga autorët. Duke parë këto mendime të arsyetuara të gjyqtarit-hetues dhe Gjykatës së Apelit, ku mendimet e kësaj të fundit u rishikuan edhe nga Gjykata Supreme, Qeverisë nuk ju kërkua asnjë shpjegim, siç e pranon edhe shumica (shiko paragrafin 60 të vendimit); dhe sipas mendimit tim Qeveria nuk ishte as në një pozicion të tillë për ta bërë këtë gjë.

Në vendimin Doorson, (loc.cit., pp. 470-471, pa marrë parasysh nevojën për 71) Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme që vendimi për të ruajtur anonimatën e dëshmitarëve të ishte i arsyeshëm, në rast të një kanosje aktuale kundër tyre dhe që përvoja e mëparshme mund të ishte e rëndësishme. Në çështjen në fjalë duhet të merret parasysh fakti që disa nga dëshmitarët ishin plagosur gjatë ndjekjes së grabitësve. Edhe duke marrë parasysh pikëpamjen se profesioni i oficerit të policisë nënkupton një farë rreziku, kjo nuk do të thotë se ai duhet të marrë përsipër rreziqe të panevojshme dhe sigurisht që nuk do të thotë se jeta dhe siguria e familjeve të tyre meritojnë më pak mbrojtje se ajo e personave të tjerë. “Detyrimi i përgjithshëm për bindje ndaj organeve ekzekutive të Shtetit” (shiko paragrafin 55 të vendimit), që duhet të kenë policët nuk nënkupton se jeta dhe siguria e tyre dhe e familjeve të tyre duhet të jetë më pak e mbrojtura. Për këtë arsye nuk jam dakord me shumicën mbi faktin që, për arsyen e vetme se në çështjen në fjalë janë përfshirë pjesëtarët e forcave të policisë, çështja duhet të dallohet nga ajo Doorson për atë që ka të bëjë me baraspeshimin e interesave të mbrojtjes me ato të dëshmitarëve në fjalë.

Fakti që Z. Engelen, i cili fillimisht kishte bërë një deklaratë që i fajësonte të pandehurit, nuk i ishte dhënë anonimati nga policia dhe nuk kishte pësuar asnjë dëm nga ankuesit, nuk është përcaktues. Policia në këtë rast mund të ketë bërë një gabim duke

zbuluar identitetin e tij, por në çdo çështje tjetër të mevonshme, ngjarjet nuk zhvlehtësojnë automatikisht dhe në mënyrë prapavepruese një gjykim të arsyeshëm të frikës.

7. Unë nuk e kuptoj se përse policët duhet të jenë të detyruar të dëshmojnë në seancë të hapur gjyqësore (shiko paragrafin 56 të vendimit), duke qënë se kjo është një detyrë civile e parashikuar me ligj. Madje, edhe sikur dikush të jetë dakord se përdorimi i policëve si dëshmitarë anonimë, “duhet të kufizohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme” (ibid.), nga ana tjetër mund të thuhet se anonimat i tyre duhet të hasë më pak kundërshtime nga ana e mbrojtjes, për arsye se dëshmitë e tyre janë thënie profesionistësh që jepen nën betim, dhe se identiti dhe kompetencat hetimore që ata kanë mund të kontrollohen me lehtësi nga gjyqtari-hetues.

8. Shumica, gjithashtu trajton çështjen nëse “nevojat e funksionimit” përbëjnë justifikim të mjaftueshëm për të ruajtur anonimat e oficerëve të policisë. Në këtë rast do t’i referoheni Memorandumit Shpjegues të Ligjit të 11 Nëntorit 1993, në të cilin Qeveria Hollandeze jep mendimin e saj se interesat mund të ruhen duke vendosur kufizime më pak ekstreme mbi të drejtat e mbrojtjes. Megjithatë, sipas mendimit tim, ky problem ka pak rëndësi për çështjen në fjalë, duke qënë se gjykata e Apelit në vendimin e saj deklaroi se, nga argumentat e paraqitura nga dëshmitarët për ruajtjen e anonimatit të tyre, ajo e vlerësoi “përcaktues” argumentin që kishte të bënte me sigurinë personale të këtyre dëshmitarëve dhe familjeve të tyre (shiko paragrafin 26 të vendimit).

9. Nuk mund të mohohet – dhe në të vërtetë nuk është mohuar – se mundësia e mbrojtjes për të pyetur dëshmitarët nuk ishte e pakufizuar. Dhe as në situata normale, kur identiteti i dëshmitarëve është i njohur, ajo nuk është e pakufizuar. Fakti që disa pyetjeve nuk iu dhanë përgjigje nga dëshmitarët dhe fakti që ky veprim u pranua nga gjyqtari-hetues, mund të jetë i hapur për diskutime, por ka shumë mundësi që kjo të ndodhte edhe sikur dëshmitarët të ishin pyetur në seancë të hapur gjyqësore, por të maskuar. Për këtë arsye, mund të lindë pyetja nëse ishte e domosdoshme dhe në përpjestim që të refuzohej përgjigja ndaj disa pyetjeve të bëra nga mbrojtja me qëllim që të mbrohej anonimat i dëshmitarëve dhe fshehtësia e taktikave të policisë. Megjithatë, kësaj pyetjeje duhet t’i japë përgjigje në radhë të parë gjykata e brendshme kompetente, dhe realisht asaj iu dha përgjigje pozitive nga gjyqtari-hetues dhe, edhe kur pas vendimit ajo u kundërshtua nga mbrojtja përpara Gjykatës së Apelit, edhe kjo e fundit dha të njëjtën përgjigje. Në përgjithësi, sipas mendimit tim, as kufizimet e kërkuara nga situata dhe as ato të pranuar nga gjyqtari-hetues ishin të tilla sa të justifikonin interpretimin që nuk ekzistonte “mundësia e përshtatshme për të pyetur dëshmitarët” sic kërkohej nga Gjykata në vendimin Kostovski. (loc., cit., p. 20, § 41). Pra, mangësitë me të cilat u përball mbrojtja gjatë punës së saj, ishin baraspeshuar mjaftueshëmrisht nga procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore (shiko vendimin Kostovski, p. 21, § 43, dhe vendimin Doorson, p. 472, § 76).

10. Si përfundim, megjithëse thëniet e dëshmitarëve anonimë përbënin një pjesë thelbësore të provave, nuk mund të thuhet se vendimet për shpalljen fajtorë të ankuesve bazoheshin vetëm në këto dëshmi. Nëse këto vendime janë bazuar në këto thënie “në një

masë përcaktuese”, sic pretendon shumica (paragrafi 63 i vendimit), kjo është vështirë të thuhet. Unë mbështes mendimin e shprehur nga Përfaqësuesi i Komisionit në proçesin përpara Gjykatës, që ky kriter i përcaktuar në vendimin Doorson (p. 472, § 76), është i vështirë për t’u zbatuar, sepse nëse dëshmia e dëshmitarëve anonimë përdoret nga gjykata si provë, kjo do të ndodhë sepse gjykata e vlerëson atë si pjesë “përcaktuese” të kësaj prove, duke e bërë provën të plotë ose të paktën të mjaftueshme. Edhe në këtë rast duhet të mbizotërojë interpretimi i Gjykatës se “si rregull i përgjithshëm i përket gjykatave të brendshme të vlerësojnë provat e paraqitura përpara tyre” (paragrafi 50 i vendimit në fjalë). Për më tepër, sic është thënë dhe më lart (shiko paragrafin 3(h) më lart), në lidhje me këtë, faktet e çështjes nuk duket se ndryshojnë thelbësisht nga ato të çështjes Doorson.